



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 359/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Faton Ademi dhe Fejzullah Rexhepi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rexhep Mazreku, kandidat për deputet nga radhët e koalicionit NISMA-AKR-PD, paraqitur kundër komisionarëve të Vendvotimit 3047a/01 në komunën e Malishevës, për shkak të mungesës të votave në ditën e votimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 09.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pa lejuar ankesa e Rexhep Mazreku kandidat për deputet nga radhët e koalicionit NISMA-AKR-PD, paraqitur kundër komisionarëve të Vendvotimit 3047a/01, me të cilën ka kërkuar rinumërimin e votave në 3047a/01, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 08.10.2019, nga Rexhep Mazreku, kandidat për deputet nga radhët e koalicionit NISMA-AKR-PD, paraqitur kundër komisionarëve të Vendvotimit 3047a-01 në Malishevë, në të cilën pretendon se nga KKZ-ja është informuar se sipas raportit të komisionarëve të këtij VV, votat me të cilën iu kanë dedikuar nuk janë të evidentuara dhe sipas ankuesit i mungojnë 83 vota. Paraqitësi i ankesës kërkon nga KQZ-ja e veçanërisht nga QNR-ja, të vërtetoj se a janë votat të cilat ishin për kandidaturën e tijë në origjinal sepse kopja e origjinalit nuk është e saktë, apo ka devijuar nga evidentimi i saktë.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli vlerëson se pretendimi i palës ankuese edhe pse i referohet parregullsive në ditën e votimit, për shkak se përmes kësaj ankese atakohet rezultatit i cili është ende si rezultat preliminar, e i cili rezultat mund të ndryshoj, ankesa në këtë fazë të procesit zgjedhor është e parakohshme, për shkak se pas publikimit të rezultatit përfundimtar i njëjti rezultat është i

ankimueshëm nga subjektet politike edhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numrin e votave të tyre. Meqenëse në aspektin kohor-faza e procesit zgjedhor kur parashtrrohet ankesa është e parakohshme ankesa duhet të hudhet poshtë e palejueshme. Në momentin e publikimit të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, mund të ushtroj ankesën në afatin prej 24 orëve.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe Nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “Ankesat të cilat janë të palejuar dhe të pasafatshme PZAP-i i hudhë poshtë me vendim”, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendosja sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi për hudhjen e ankesës të palejueshme nuk e prejjudikon rezultatit përfundimtar e po ashtu me të njëjtat pretendime ankimore palët mund ta atakojnë/apelojnë rezultatit përfundimtar.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A nr. 359/2019 më datën 08.10.2019

Kryesuesi i Panelit
Adnan Kenushevi

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*